RAPORT

Mbi zbatimin e rekomandimeve sipas Rezolutës së Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së INSTAT për vitin 2024

Rekomandimi nr.1. Të vijojë puna për publikimet tematike "Post Census", me analiza që u përgjigjen nevojave të politikave publike, planifikimit vendor dhe kërkimit shkencor, dhe të përditësohet platforma e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Statusi: Në proces

Në kuadër të këtij rekomandimi, INSTAT ka publikuar analiza me tematikën "Fëmijët dhe të Rinjtë në Shqipëri", gjithashtu po punohet intensivisht për përfundimin e dy analiza tematike "Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri" dhe "Profili i personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri". Gjithashtu, INSTAT po vijon punën për përditësimin e platformës për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, dhe në kuadër të zbatimit të projektit statistikor 7.2 për SDG pritet një ekspertizë e huaj brenda tremujorit të parë të vitit 2026, për të përmirësuar dhe populluar këtë platformë.

Rekomandimi nr.2. Të rrisë numrin e treguesve në platformën "Geodata Hub" dhe "Web GIS", si dhe të zhvillohen materiale orientuese dhe tutoriale për përdorues joteknikë, veçanërisht për njësitë e statistikave vendore dhe planifikuesit urban.

Statusi: Realizuar

Në zbatim të rekomandimit nr.2 të rezolutës së Kuvendit, INSTAT parashikoi dy aktivitetet e mëposhtme:

- Video shpjeguese për përdorimin e Geodata Hub dhe WebGIS;

- Udhëzues për përdorimin e Dashbordit të Bashkive.

Këto aktivitete u realizuan në gjysmën e dytë të vitit 2025.

Aktiviteti i parë mbi "Video shpjeguese për përdorimin e Geodata Hub dhe WebGIS" është realizuar dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Materiali ndodhet në platformën "Geodata Hub" (https://geodatahub.instat.gov.al/) në seksionin e WebGIS ku shpjegohet përmbajtja dhe përdorimi i WebGIS (https://instatgis.gov.al/resources/tutorial_al.mp4).

Udhëzues për përdorimin e Dashbordit të Bashkive - Në seksionin e Statistikave Rajonale të "Geodata Hub" është përgatitur dhe publikuar "Manuali për dashbordin e bashkive". Manuali ofrohet në gjuhën shqipe, ndërsa Dashbordi i Bashkive ofrohet në dy gjuhë, shqip dhe anglisht dhe është ekskluzivisht i populluar me tregues në nivel bashkie. Treguesit janë të gjithë të njëjtë dhe të disponueshëm për 61 bashkitë, duke ofruar në këtë mënyrë mundësi krahasimi ndërmjet vetë njësive të vetëqeverisjes vendore, por dhe krahasimin e vlerave lokale me vlerat mesatare në rang vendi. Dashbordi ofron statistika të prodhuara nga burime të ndryshme, si censet, vrojtimet,

regjistrat dhe burime administrative, ku bashkitë janë një nga ofruesit e të dhënave. Të dhënat do të përditësohen çdo vit, duke ruajtur vazhdimësinë dhe garantuar serinë kohore.

Rekomandimi nr.3. Të vijojë përgatitjet për realizimin e Censit të Ekonomive Bujqësore, ndjekur nga një strategji organizimi, kalendar të aktiviteteve dhe burime të përcaktuara financimi. Të bashkëpunohet me Ministrinë e Bujqësisë, FAO, Eurostat dhe të ndërmarrë një fushatë informuese për fermerët.

Statusi: Në proces

INSTAT-i po vazhdon punën për përditësimin e strategjisë dhe kalendarit të aktiviteteve për realizimin e Censit të Bujqësisë 2026.

Aktualisht, këto dokumente janë në proces të përditësimit për të siguruar një planifikim të plotë dhe të detajuar të aktiviteteve, në përputhje me rregullat dhe standardet e kërkuara nga BE-ja dhe nevojat kombëtare.

INSTAT- ka përfunduar disa aktivitete kyçe në kuadër të Censit të Bujqësisë, duke përfshirë zhvillimin e draft Pyetësorit të Censit të Bujqësisë, në përputhje me rregulloret e BE-së (Rregullorja (BE) 2018/1091 dhe Rregullorja Zbatuese (BE) 2024/2914).

Ky proces është realizuar në bashkëpunim me ekspertët e BE-së.

Aktualisht, aktivitetet të cilat janë në proces të zhvillimit përfshijnë:

- Përfundimin e përgatitjeve metodologjike dhe organizative;
- Ndjekjen e miratimit të ligjit për Censin e Bujqësisë;
- Ndërtimin e Kornizës së Regjistrimit të Bujqësisë dhe koordinimin me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Mbrojtjen e buxhetit për realizimin e Censit dhe rishikimin e grupit të punës;
- Testimin e pyetësorit dhe zhvillimin e aplikacionit CAPI për intervista;
- Rritja e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së sistemeve që do të përdoren gjatë operacionit të censit;
- Garantimi i kapaciteteve të nevojshme të serverave dhe bazave të të dhënave për ruajtjen dhe përpunimin e informacionit të mbledhur;
- Mbështetja e komunikimit dhe transmetimit të të dhënave në mënyrë të sigurt dhe të kontrolluar;
- Trajnimin e stafit dhe ngritjen e logjistikës për realizimin në terren;
- Komunikimin dhe ndërgjegjësimin me palët e interesuara, duke përfshirë fermerët, shoqatat dhe autoritetet lokale.

INSTAT-i është angazhuar në përgatitjen e detajuar të këtyre aktiviteteve dhe do të vazhdojë me implementimin e plotë të Censit sipas afateve të përcaktuara dhe në përputhje me kërkesat ndërkombëtare dhe kombëtare. Gjithashtu, INSTAT është në fazën e përfundimit të Strategjisë së Komunikimit të Censit të Ekonomive Bujqësore dhe planit të aktiviteteve që lidhen me të.

Rekomandimi nr.4. Të vazhdojë të udhëheqë koordinimin teknik dhe institucional me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave për përgatitjen e metadata-ve me standardet e FMN-së dhe përshtatjen e treguesve sipas SDDS.

Statusi: Në proces

Në lidhje me këtë rekomandim, drejtoritë prodhuese po analizojnë treguesit statistikorë që INSTAT prodhon të cilët përfshihen në tabelat e kërkuara në lidhje me periodicitetin e raportimit (mujor/tremujor). Në vazhdimësi do të vijojë puna koordinuese me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë.

Rekomandimi nr.5. Të vazhdojë punën për përmirësimin e llogarive sektoriale dhe financiare sipas standardeve të ESA 2010 dhe të sigurojë transmetimin në Eurostat.

Statusi: Në proces

INSTAT në zbatimi të këtij rekomandimi ka vijuar në mënyrë të qëndrueshme procesin e vlerësimit të treguesve statistikore, me fokus të veçantë përmirësimin e afateve të publikimit dhe rritjen e plotësisë së serive kohore. Ky proces përbën një angazhim të vazhdueshëm dhe zhvillohet paralelisht me zbatimin e planit të punës për përmbushjen e piketave mbyllëse të Kapitullit 18 "Statistikat", në kuadër të procesit të Integrimit Evropian, duke përfshirë jo vetëm përmirësimin e tabelave dhe treguesve statistikë, por edhe përafrimin e kuadrit ligjor dhe institucional me acquis communautaire.

Rekomandimi nr.6. Të përmirësojë statistikat mjedisore dhe të energjisë përmes zhvillimit të llogarive për emetimet në ajër, flukset fizike të energjisë dhe taksat mjedisore sipas sektorëve ekonomikë.

Statusi: Në proces

INSTAT nëpërmjet projekteve statistikore ka arritur të llogarisë statistikat mbi llogaritë e emetimeve në ajër, flukset fizike të energjisë dhe taksat mjedisore sipas sektorëve ekonomikë INSTAT po vijon punën për përmirësimin e mëtejshëm të treguesve të cilat transmetohen në EUROSTAT që nga Dhjetori i vitit 2023. INSTAT parashikon publikimin e këtyre statistikave në fund të vitit 2027 dhe do të vazhdojë të përmirësojë këto të dhëna, duke shtuar numrin e indikatorëve nëpërmjet bashkëpunimit të vazhdueshëm me institucionet furnizuese me të dhëna.

Rekomandimi nr.7. Të hartojë një kornizë strategjike për përdorimin e metodave moderne në prodhimin statistikor, me qëllim plotësimin e nevojave të përdoruesve në kohë dhe të detajuara.

Statusi: Në proces

Në zbatim të rekomandimit për hartimin e një kornize strategjike për përdorimin e metodave moderne në prodhimin statistikor, INSTAT ka nisur dhe vijon procesin e modernizimit të praktikave të prodhimit statistikor, me fokus në rritjen e kapaciteteve digjitale, automatizimin e proceseve dhe përdorimin e zgjidhjeve inovative për të përmbushur në mënyrë më efikase dhe në kohë nevojat e përdoruesve për të dhëna të detajuara.

Në këtë kuadër, janë evidentuar si prioritete kryesore: digjitalizimi dhe modernizimi i sistemeve të mbledhjes së të dhënave (CAPI/CAWI/CATI), rritja e përdorimit të burimeve administrative dhe integrimi i tyre me sistemet statistikore, përdorimi i metodave dhe instrumenteve moderne për përpunim të automatizuar, kontroll cilësie dhe monitorim të vazhdueshëm të flukseve statistikore, si dhe forcimi i sistemeve të menaxhimit të të dhënave dhe metadatave, me qëllim që produktet statistikore të ofrohen në formate të aksesueshme dhe të përshtatshme për kategori të ndryshme përdoruesish.

Paralelisht, në kuadër të ndërtimit të kësaj kornize strategjike, po punohet për përditësimin dhe zhvillimin e sistemeve të informacionit që mbështesin proceset statistikore, dokumentimin dhe standardizimin e proceseve sipas qasjes GSBPM, si dhe fuqizimin e kapaciteteve të stafit përmes trajnimeve dhe projekteve të specializuara (përfshirë rritjen e kapaciteteve në gjuhën R dhe mjete të tjera analitike). Gjithashtu, po ndërmerren masa për të garantuar sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemeve digjitale, duke pasur parasysh rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave dhe vijueshmërisë së shërbimeve.

Kjo qasje synon të sigurojë që INSTAT të ofrojë statistika më të shpejta, më të detajuara dhe më të përshtatura me nevojat e përdoruesve, duke garantuar njëkohësisht standardizim metodologjik, cilësi të lartë dhe integritet të të dhënave, në përputhje me praktikat evropiane dhe ndërkombëtare.

Rekomandimi nr.8. Të mbajë aktive dhe të përditësojë rregullisht faqen e INSTAT-it në të gjitha kategoritë: statistika, publikime dhe dokumentim, si mjeti kryesor i aksesueshmërisë dhe komunikimit të INSTAT-it.

Statusi: I vazhdueshëm

Në lidhje me Rekomandimin nr. 8, faqja zyrtare e INSTAT-it mbahet aktive dhe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha kategoritë e saj kryesore, përfshirë statistikat, publikimet dhe dokumentimin shoqërues. Përditësimi realizohet në përputhje me kalendarin zyrtar të publikimeve, si dhe me parimet e aksesueshmërisë, transparencës dhe komunikimit me përdoruesit. Faqja e internetit shërben si mjeti kryesor për shpërndarjen e informacionit statistikor zyrtar dhe për sigurimin e aksesit të barabartë të publikut ndaj të dhënave dhe publikimeve të INSTAT-it.

Rekomandimi nr.9. Të shpallë vakancat dhe të rekrutojë sa më shpejt stafin sipas sektorëve që paraqesin mangësi.

Statusi: I vazhdueshëm

Në vijim të masave për zbatimin e këtij rekomandimi, INSTAT ka ndërmarrë një sërë veprimesh të orientuara drejt forcimit të menaxhimit të burimeve njerëzore, uljes së lëvizshmërisë së stafit dhe rritjes së motivimit profesional.

Për vitin 2025, është miratuar një shtesë prej 24 pozicionesh në strukturën organizative të institucionit, e cila përbën një hap të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të efiçencës së punës,

rritjes së cilësisë së prodhimit statistikor dhe uljes së ngarkesës individuale në disa njësi strukturore. Ky zhvillim është shoqëruar me rishikimin dhe riorganizimin e strukturave dhe pozicioneve, me synimin për të optimizuar burimet dhe për të siguruar një shpërndarje më të drejtë të përgjegjësive.

Në këtë kuadër, gjatë periudhës Shkurt–Dhjetor janë shpallur gjithsej 55 pozicione vakante për rekrutim. Nga këto, 32 pozicione janë plotësuar me sukses, ndërsa 16 pozicione janë mbyllur pa fitues. 11 pozicione janë plotësuar përmes procedurës së ngritjes në detyrë, 2 pozicione përmes lëvizjes paralele, ndërsa 19 pozicione janë plotësuar përmes pranimit në shërbimin civil; 7 pozicione vakante janë ende në proces rekrutimi dhe pritet përfundimi i procedurave përkatëse.

INSTAT do të vijojë zbatimin e rekomandimeve në përputhje me legjislacionin për shërbimin civil, me qëllim plotësimin e vendeve vakante.

Rekomandimi nr.10. Të përmirësojë mbledhjen e statistikave për kërkimin dhe inovacionin duke forcuar bashkëpunimin ndërmjet universiteteve dhe sektorit privat, mbështetur në manualet metodologjike të Frascati-t dhe Oslo-s.

Statusi: Në proces

Instituti i Statistikave, në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe mbulueshmërisë së statistikave mbi kërkimin shkencor dhe inovacionin, ka ndërmarrë një sërë veprimesh konkrete të orientuara drejt forcimit të bashkëpunimit institucional dhe harmonizimit metodologjik me standardet ndërkombëtare.

INSTAT ka forcuar bashkëpunimin me institucionet e arsimit të lartë, institucionet shtetërore dhe ndërmarrjet private, me qëllim sigurimin e qasjes më të gjerë në burimet e të dhënave dhe rritjen e mbulueshmërisë së aktiviteteve të kërkimit dhe inovacionit në vend. Ky bashkëpunim synon të krijojë një rrjet të qëndrueshëm komunikimi dhe shkëmbimi informacioni, duke rritur besueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave të mbledhura.

Për të garantuar që statistikat e prodhuara janë plotësisht të harmonizuara me standardet ndërkombëtare, INSTAT përditëson periodikisht pyetësorët e përdorur për mbledhjen e të dhënave, në përputhje të plotë me udhëzimet dhe konceptet metodologjike të përcaktuara në manualet Frascati (për kërkimin dhe zhvillimin eksperimental) dhe manualin Oslo (për matjen e inovacionit). Ky proces përditësimi siguron adaptimin e metodave më të fundit të matjes, rritjen e saktësisë së klasifikimeve dhe përfshirjen e treguesve të rinj të rëndësishëm për analizat statistikore.

Gjithashtu, INSTAT po zgjeron gamën e treguesve statistikorë të publikuar në faqen e tij zyrtare, duke ofruar të dhëna më të detajuara dhe më të frekuenta mbi aktivitetin kërkimor dhe inovativ të ndërmarrjeve dhe institucioneve kërkimore në vend. Linku i publikimeve të statistikave për kërkimin shkencor dhe zhvillimin: Kërkimi dhe zhvillimi

Në kuadër të detyrimeve të rregulloreve evropiane, INSTAT realizon gjithashtu mbledhjen, përpunimin dhe transmetimin në Eurostat të statistikave mbi Fondet e Alokuara nga Buxheti i Shtetit për Kërkim dhe Zhvillim (GBARD), duke respektuar periodicitetin dhe afatet e përcaktuara. Raportimi i rregullt i këtyre të dhënave kontribuon në harmonizimin e statistikave kombëtare me ato të Bashkimit Europian dhe rrit cilësinë e vlerësimeve ndërkombëtare mbi investimet publike në kërkimin shkencor.

Përmes të gjithë këtyre iniciativave, INSTAT synon të ofrojë një pasqyrë sa më të plotë, gjithëpërfshirëse dhe të besueshme të aktivitetit kërkimor dhe inovacionit në ndërmarrje dhe në institucionet kërkimore në vend, duke mbështetur zhvillimin e politikave kombëtare të bazuara në statistika cilësore dhe të harmonizuara ndërkombëtarisht.